

20151935332

L I G J
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR THEMELIMIN E AGJENCISË
PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL

Neni 1

Në Ligjin për themelimin e Agjencisë për Përkrahje Financiare në Bujqësinë dhe Zhvillimin rural (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 72/2007, 5/2009 dhe 43/14), në nenin 34-a në paragrafin (1) fjalët: “3.000 deri” shlyhen.

Paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 30% nga gjoba e matur për personin juridik do t’i shqiptohet edhe personit përgjegjës në personin juridik për kundërvajtjet nga paragrafi (1) i këtij neni.”

Neni 2

Në nenin 34-b fjalët: “prej 1.000 deri 3.000” zëvendësohen me fjalët: “prej 500 deri 750”.

Neni 3

Neni 34-v ndryshohet si vijon:

“Neni 34-v

Për kundërvajtjet e përcaktuara në këtë ligj, procedurë kundërvajtëse mban dhe sanksione kundërvajtëse shqipton gjykata kompetente.”

Neni 4

Pas nenit 34-v shtohen dy nene të reja 34-g dhe 34-d si vijojnë:

“Neni 34 – g

Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenin 34-a nga ky ligj, inspektori shtetëror për bujqësi është i detyruar kryerësit t’i propozojë procedurë për barazim me lëshimin e urdhëresës pagesore kundërvajtëse, para se të parashtrijë kërkesë për ngritjen e procedurës kundërvajtëse, në pajtim me Ligjin për inspektoratin shtetëror për bujqësi.

Neni 34 – d

Matja e lartësisë së gjobës për personin juridik bëhet në pajtim me Ligjin për kundërvajtjet.”

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë”.